



**VDEKJA, KY ÇAK
I PAEVITUESHËM
DREJT SË PËRTEJMES..!**



**RRETH KUPTIMIT
TË SUNETIT**



**GJASHTË VEPRA QË KANË
SEVAPIN E HAXHIT**

Viti XV - Nr. 9 (175),
Shtator, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Madhështia e një feste

që na ndërgjegjëson..!



**“SI DO TË VEPRONI ATË DITË,
KUR DO TA SHIHNI TË MIRËN TË KEQE DHE TË KEQEN TË MIRË?!”**

Zgjohuni dhe hapni sytë! Mos lejoni që mbetjet e të tjerëve të na shiten për pasuri e nder! Mos lejoni që fëmijët t’jua marrin për duarsh e t’jua konvertojnë në djaj të vegjël, që nesër do ta shkatërrojnë Shqipërinë, më shumë se ç’është shkatërruar e sfilitur!

Ne jemi muslimanë; e kemi të shenjtë fenë, jetën, mendjen, nderin dhe pasurinë! E kemi të shenjtë ta ndërtojmë jetën me vlerat e besimit tonë, sikurse e kemi të shenjtë ta ndalojmë të keqen dhe ta mbrojmë të mirën me krejt fuqitë që kemi!



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të vetëm të gjithësisë, Atij që na sheh e na dëgjon, na furnizon me begatitë e Tij, që asnjëherë nuk sosën dhe kurrë nuk pushojnë së vërshuari ndaj krijesave të Tij, të njohura e të panjohura nga raca njerzore! Urdhëron dhe thotë në surën e Hz. Nuhut (a.s.): [Unë u thashë: “Kërkujini falje Zotit tuaj, se Ai vërtetë është Falës i madh; Ai ju lëshon nga qielli shi me bollëk, ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshte dhe ju jep lumenj! Ç’është me ju, që All-llahut nuk i shprehni madhërimin që i takon? Kur Ai ju krijoi në disa etapa!”]

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot, në këtë ditë e në çdo ditë e moment të jetës sonë, Ma të Mirë e Ma të Shtrenjtë, Hz. Muhamedit (a.s), i cili udhëzonte:

“Si do të veproni atë ditë kur do të devijojnë të rinjtë tuaj dhe do të shthurren gratë tua?” I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq?

Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur nuk do të urdhëroni më për të mirë dhe s’do e ndaloni më të keqen?” I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq?

Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur do të urdhëroni për të keq dhe do ta ndaloni të mirën?” I thanë: Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguar i All-llahut? Tha: “Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!” I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq?

Tha: “Si do të veproni atë ditë, kur do ta shihni të mirën të keqe dhe të keqen të mirë?!”

“SI DO TË VEPRONI ATË DITË, KUR DO TA SHIHNI TË MIRËN TË KEQE DHE TË KEQEN TË MIRË?!”

“E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’u jepnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtuan, prandaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan!”

TË DASHUR DHE TË NDERUAR VËLLEZËR DHE MOTRA, BESIMTARË DHE BASHKËQYTETARË TË MI,

Në takim e kësaj fillimjave, bashkë me imamët e nderuar, bashkëbiseduam rreth realiteteve të përditshme të vendit tonë. Ndamë së bashku mendime të vyera e plot dobi në lidhje me alternativën e besimit, që e shohim të arsyeshme ta vendosim si këshillë të singertë para duarve të shoqërisë sonë, duke pyetur, tamam siç Kur’ani pyet: “Ku po shkoni?”, ndryshe thënë: Ku po përfundon ky rrugëtim i paorientuar i shoqërisë shqiptare?

Dikur, luftohej me të madhe besimi dhe feja, si shkak prapambetjeje dhe rrezik fanatizmi. Sot, morali i besimit dhe fesë është hedhur mënjanë; haramet dhe sprovat që pasojnë praktikimin e tyre në masë, kanë mbytur vendin, si një mjegull e padëshiruar, që të pengon pamjen dhe të vështirëson ecjen përpara!

Ku po shkon shoqëria shqiptare, individit shqiptar, që përpëlitet në mes të propagandave të reja, të veshura me turlitakam rrobash e maskash, si e si ta tërheqin drejt humnerës së degradimit moral e human, për t’u kthyer më e mira e krijesave të Zotit; Njeriu, në kavië eksperimentale në laboratorët e pasuesve të së keqes dhe frymëzuesve të saj?!

Është gjynah, pasha All-llahun, ajo çfarë shohim e dëgjojmë të përhapet çdo ditë në vendin tonë!

All-llahu Mëshirëplotë, urdhëron në Kur’anin Famëlartë: “E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t’u jepnim begati nga qielli e toka, por ata përgënjeshtuan, prandaj i dënuam me shkatërrim për atë që merituan!”

VËLLEZËR DHE MOTRA,

Hapni sytë dhe pendohuni, kthehuni nga Zoti me një pendim të pakthyesëm dhe deklaroni paqtimin me Zotin e botrave, për të dëshmuar kthimin e begatisë, qetësisë, sigurisë, mirëqenies e harmonisë në mes nesh!

Po humbet besimi në Zot, frika e Tij! Po kthehet e keqja në moral dhe morali në prapambetje! Po paragjykohen bijat tona për hixhabin e besimit dhe djemtë tanë për ruajtjen e nderit dhe distancimin nga haramet dhe ndalesat e shumta, që sot shiten si liri e nevojë e kohës!

Po nëpërkëmbet Zoti, feja dhe prindi! Po mohohet Zoti dhe po kërkohet të heshten minaret e besimit! Po vriten nana dhe baba, po mbytet gruaja

**ËSHTË MOMENTI TË NDAHEMI
NGA INJORANCA, TË FTOJMË
SHOQËRINË TONË TË DISTANCOHET
NGA KUMARI, NGA LOJRAT E FATIT,
NGA ALKOOLI DHE USHQIMET
E PAKONTROLLUARA, NGA MASHTRIMI
DHE ABUZIMI ME JETËN E TJETRIT;
DUKE NISUR NGA BIZNESET
DHE INDUSTRIA E USHQIMIT,
BUJOËSIA DHE BLEGTORIA,
PESHKIMI DHE TREGËTIA!**

dhe fëmija, po bekohet shthurra dhe devijimi në emër të vlerave evropiane! Vlerat tona ne i peshojmë me Kur’an dhe me udhëzimet e Hz. Muhamedit (a.s); po peshuan, mirë se të vijnë, e nëse jo, nuk hyjnë në sytë tanë, as duhet të lejohet përhapja e tyre në mes nesh! Vlerat i çmojmë me peshoren e besimit tonë, jo çfarë na jepet si kuti e dyllësor që duhet pranuar symbyllur!

Zgjhuni dhe hapni sytë! Mos lejoni që mbetjet e të tjerëve të na shiten për pasuri e nder! Mos lejoni që fëmijët t’jua marrin për duarsh e t’jua konvertojnë në djaj të vegjël, që nesër do ta shkatërrojnë Shqipërinë, më shumë se ç’është shkatërruar e sflitur!

Ne jemi muslimanë; e kemi të shenjtë fenë, jetën, mendjen, nderin dhe pasurinë! E kemi të shenjtë ta ndërtojmë

jetën me vlerat e besimit tonë, sikurse e kemi të shenjtë ta ndalojmë të keqen dhe ta mbrojmë të mirën me krejt fuqitë që kemi!

Këto ditë kemi dëshmuar krime dhe vrasje, padrejtësi e zaptime, jemi përballur me zullume të panumërta në sakrificën tonë për ruajtjen dhe zhvillimin e pronave tona legjitime, si: në Zdralej, Zogaj, Qafë, Dudas e shumë e shumë vende të tjera, ku shohim neglizhencën e Bashkisë, Prokurorisë, Gjykatës, por jo vetëm, për të çuar në vend një hak të nëpërkëmbur prej dekadash...!

Po ndjekim me shqetësim të madh përhapjen e zjarreve përreth Shkodrës dhe mbarë vendit, thatësirën e kësaj stine, që e tejkalon natyrën e zakonshme të verës në vendin tonë, mungesën e reshjeve begatuese, shoqëruar me përhapjen në masë të alkoolit, muzikës shurdhuese pa asnjë kriter disiplinues, lakuriqësinë dhe përhapjen e imoralitetit, tradhëtisë bashkëshortore dhe divorcet përherë e në rritje për shkak të devijimit nga besimi dhe morali i fesë, abortet abuzive dhe përhapjen e drogërave të ndryshme, kultivimin e bimëve narkotike dhe shtimin e fajdeve, përhapjen e injorancës dhe veshjen e saj me kollare e kostum, por jo vetëm kaq!

KU PO SHKON INDIVIDIT DHE SHOQËRIA E JONË?

Është momenti më i mirë, që në këtë muaj të shenjtë, prej muajve hurum, të kthehemi nga Zoti e të kërkojmë falje, të pendohemi me zemër që në këtë moment; gjithësecili të bëjë nijet të singertë në zemrën e tij dhe t’i premtojë Zotit në heshtje, për të rregulluar diçka në sjelljen e tij, në familjen e tij, me bashkëshorten e tij, me fëmijët e tij, me farefisin e të njohurit, të kontrollojë gjuhën e t’i vejë fre asaj, të mos tolerojë sharje e fyerje, sepse gjuha që shan është e padenjë për të dëshmuar mirësi e bekime nga Zoti! Si mund ta lutësh Al-llahun me një gjuhë, që të është pezmatuar nga lloj-lloj fjalësh të pakontrolluara që dalin prej saj? Ajo gjuhë ka nevojë për një gusël të madh për ta pastruar nga xhunubllëku i hutimit!

Është momenti të ndahemi nga injoranca, të ftojme shoqërinë tonë të distancohet nga kumari, nga lojrat e fatit, nga alkooli dhe ushqimet e pakontrolluara, nga mashtrimi dhe abuzimi me jetën e tjetrit; duke nisur nga bizneset dhe industria e ushqimit,

bujqësia dhe blegtoria, peshkimi dhe tregëtia!

Kinie frikë Zotin dhe tutuni nga ndëshkimi i Tij! Merrni mësim nga e shkuara dhe mos e shitni fenë dhe nderin, karakterin dhe kombin! Mos u largoni nga toka e juaj e mos ia ktheni shpinën Shkodrës e Shqipërisë! Ata që e kanë katandisur vendin në këtë greminë, nuk meritojnë ta drejtojnë të sotmen dhe të ardhmen e tij, ndërsa ata që janë besuar ta udhëheqin vendin dhe të ardhmen e tij, ta kenë frikë Zotin e të pendohen para duarve të Tij, duke u lutur që të nderohen me pergjegjësinë që kanë mbi supe, se ka Zot e ka ditë llogarie, kur ca fytyra do të ndriçojnë e ca të tjera do të nxihen!

Thirrja e Myftiut dhe e imamëve tuaj sot, është më e fortë dhe më e bashkuar se kurrë: Të kthehemi nga All-llahu e të kërkojmë falje, të pendohemi e të lutemi për bekim e mirëqenie, ta dëbojmë shejtanin dhe partinë e tij nga jeta e jonë, të distancohemi nga e keqja dhe haramet dhe të mbrojmë fëmijët, rininë, familjen e kombin nga devijimi dhe shthurra!

Të kapemi fort pas Kur’anit dhe Traditave të Hz. Muhamedit (a.s), të pastrojmë zemrat nga paragjykimi e smira, urrejtja e intrigat ndaj njërit-tjetrit, mos ta lakmojmë pasurinë e tjetrit, por të punojmë fort për pasurimin e vendit, nëpërmjet pasurimit tonë nga rrugët e hallallit!

Të mbrojmë fort trashëgiminë e të parëve, gjurmët dhe dritën e tyre, ta dëshmojmë besimin dhe fenë tonë kudo, mos të kemi ndrojtje për ta thënë të vërtetën, edhe nëse të gjithë do ta kundërshtojnë atë!

Lutja e singertë i ka dyert e hapura dhe lutja e jonë drejtuar All-llahut, mbështetet në besim e bindje, në shpresë e përlulësi para duarve të Atij që ka në dorë gjithësinë dhe kur e do diçka e urdhëron: “Bëhu!” dhe bëhet!

All-llahumme na fal dhe na prano, na udhëzo dhe na begato, na dhuro paqtim dhe na gëzo me begatitë e Tua të pakufijshme, ja All-llah! Begatoje Shkodrën tonë, ruaje Shqipërinë dhe qytetarët e saj, bekoje tokën tonë dhe lësho mirësitë e qiellit mbi të, që të gëzojë i madh dhe i vogël, bima dhe kafsha, çdo gjallesë mbi tokë, ja Errhamerr- Rrahimine!

Amin, vel-hamdu lil-lahi Rabbil-alemine!

Shkodër, më 11 gusht 2017



Sheikh Muhamed El-Gazali:

“Pohimi: “UNË JAM MYSLIMAN”,

do të thotë, se

UNË KAM PËRQAFUAR

NJË FÉ TË NATYRSHME,

QË NDERON ORIGJINËN NJERËZORE

DHE INSTINKTET E SAJ

TË NATYRSHME.

NDERON MENDJEN NJERËZORE

DHE RREQULLAT E SAJ LOQJIKE.

I PARASHIKON QABIMET

DHE NUK E QJYKON QABIMTARIN

ME VDEKJE, POR IA SHTRON

RRUGËN E PENDIMIT

DHE IA HAP DYERT E SHPRESËS.

E VË RE URTËSINË E KADERIT NË

DIVERSITETIN FETAR DHE THËRRET

NË MENDIMIN E TIJ ME URTËSI

E KËSHILLË TË MIRË, DUKE

REFUZUAR FITNET E VRAZHDËSINË.”

Paraditën e së hënës, më 7 gusht 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh, me të cilët diskutoi realitetet e përditshme shqiptare, ku janë shtuar haramet, pasiguria për jetën, pijet alkoolike dhe ato narkotike, krimi brenda familjes, zjarret masive, thatësira, injoranca, korrupsioni, mungesa e ligjit, padrejtësitë ndaj pronarëve të ligjshëm që u janë zaptuar pronat, (si, vakëfet e Myftinisë) etj.

Myftiu theksoi se karshi këtyre realiteteve, është detyrë e Myftinisë, Myftiut, imamëve dhe thirrësve islamë, të bëjnë thirrje që njerëzit të kthehen nga Zoti, të kërkojnë falje të penduar dhe të largohen nga imoraliteti, shthurja, veset dhe mosrespektimi i fesë së Zotit.

Ai tha se tradita e muslimanëve në kësi realitetesh është të luten e të kërkojnë falje, të mblidhen bashkërisht si një zemër e vetme dhe t'i drejtohen Zotit të gjithësisht për falje e shi.

IMAMËT E SHKODRËS, HYTBE DHE LUTJE MASIVE PËR T'U DISTANCUAR NGA HARAMET



U ra dakord që hytbeja e datës 11 gusht 2017, t'i përkushtohet kësaj teme, si dhe të përgatitet një mesazh i përgjithshëm drejtuar shoqërisë, për t'u distancuar nga haramet dhe e keqja që ka përfshirë vendin.

Njëkohësisht, ditën e xhuma, në të gjitha xhamitë e Shkodrës do të bëhen lutje dhe istigfare masive për kërkim të shiut dhe mëshirës së All-llahut për krijesat e Tij!

MYFTIU LAJMËROI NDRYSHIMIN E IMAMIT TË XHAMISË TOPHANË

Mbrëmjen e së hënës, më 7 gusht 2017, pas faljes së namazit të akshamit në xhaminë e Tophanës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, lajmëroi të pranishmit për një ndryshim në strukturën e drejtimit të xhamisë.

Në prani të imamit të nderuar, Husejn Muça, Myftiu lajmëroi se pasi mori në shqyrtim kërkesën e imamit të deritanishëm për t'u liruar nga shërbimet e tij në këtë xhami, për arsye objektive,



që nuk lidhen me aktivitetin e xhamisë, vendosi të propozojë për imam/hatib të ri të xhamisë Tophanë, të nderuarin z.

Ferid Rilla.

Myftiu e prezantoi imamin e ri me xhematin, sikurse vlerësoi kontributin e çmuar të imamit Husejn Muça në shërbim të ruajtjes së harmonisë së xhematit, edukimit të fëmijëve dhe afrimit e rinisë me xhaminë.

Myftiu lajmëroi gjithashtu se, duke nisur nga e enjtja që vjen, më datë 10 gusht 2017, do të rinisë dersin e tij të përjavshëm pas akshamit në xhaminë e Tophanës.

NIS TRAJNIMI I HAXHILERËVE TË RI TË SHKODRËS



Pasditën e së martës, më 15 gusht 2017, Myftinia Shkodër nisi trajnimin treditor të haxhilerëve të sivjetshëm të Shkodrës, të cilët do të nisen pas pak ditësh drejt vendeve të shenjta për kryerjen e haxhit të këtij viti.

Në fjalën e tij të hapjes, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari uroi të gjithë të pranishmit për nijetin dhe sakrificën e këtij viti.

Myftiu tha se haxhi, si adhurim ka një vlerë të madhe në jetën e muslimanit, si një mundësi pastrimi dhe kthimi nga besimi dhe origjina e pastër humane.

Trajnimi i haxhilerëve të sivjetshëm do të realizohet nga imami Ruzhdi Plangaj, i cili do të japë udhëzimet e duhura për grupin e haxhilerëve të Shkodrës.

Prej disa vitesh, trajnimi i haxhilerëve të Shkodrës është kthyer në një traditë të mirë që i ndihmon haxhilerët në kryerjen saktë të ritualeve të umres dhe haxhit.

MESAZHI I MYFTIUT ME RASTIN E KURBAN BAJRAMIT 1438/2017

Shumë të dashur vëllezër dhe motra,

Me zemër të mirë Kurban Bajramin e këtij viti! Në fakt, çfarë zemre mund të jetë ajo që nuk ndjen, rrethuar nga padrejtësitë, dhembjet e ymmit, rënkimet e kombit, e sotmja anarkike dhe frika për të ardhmen e një shoqërie dhe një njerëzimi zhytur në pellgjet e papërgjegjshmërisë, padijes, afetarizimit dhe imorales?!

Kushdo që lexon historinë kur'anore të Hz. Ibrahimit (a.s) dhe përkushtimit të tij në jetë, kupton qartë se besimi dhe ndjenja e afrimit me Zotin, janë baza e ndërtimit të individit, familjes dhe shoqërisë. Pa këtë, na është vërtetuar katërciprisht, sesa mjeran mbetet njeriu që devijon, shoqëria që humbet rrugën dhe njerëzimi që zhytet përherë e më shumë në errësirat e civilizimit material e të zhveshur nga besimi dhe ndjenja e përkushtimit ndaj Zotit!

Nga Meka e bekuar, po ndjek me vëmendje zhvillimet e Haxhit të sivjetshëm. Takova para pak ditësh tre haxhilerët e vetëm nga Kili i largët, pa përmendur të tjerë nga mbarë globi, që madhërojnë së bashku të Vetmin Zot të gjithësisht, duke iu përgjigjur me përlule Thirrjes së Tij për Haxhin e sivjetshëm.

U ndala për pak dhe bëra një vështrim të shpejtë gjithandej botës sonë. Në Siri, akoma vazhdojnë bombardime e shkatërime të papërgjegjshme. Iraku është masakruar e shkatërruar. Palestina martire mbetet njollë shekullore turpi në ballë të një ymmit krejtësisht të fjetur, që ka nisur të shfaqë shenjat e rizgjimit dhe rimëkëmbjes! Larg në Burma, muslimanë të panumërt digjen e vriten para syve të hipokrizisë mbarëbotërore, që deklaroi fjalë pa fund, që nuk trembin dot as edhe një mizë në fluturimin e saj!? Hija e keqe e terrorit dhe vrasjes, shkatërrimit dhe përçarjes, ka kapluar kontinentin tonë,

prej ku dëgjohej akoma sot, në vitin 2017, deklarata të papërgjegjshme, krejtësisht raciste dhe injorante kundër lirive dhe besimit, nga protagonistë të diplomacive evropiane, por jo vetëm!

Vendi ynë përpëlitet në krahët e statuseve plot elokuencë në rrjetet sociale, që natyrshëm as e zgjidhin krahurën ku është katandisur, as ndjellin rreze optimizmi për një shoqëri në dilemë e kaos, me mekanizma thujtë të kalbura, për të prituri një lëvizje të rregullt e progresive të lokomotivës së saj!


Lutjet e mia të përzemërta janë që ky Bajram të vijë sa më i mbarë dhe plot bekim e shpresë për kombin tonë dhe mbarë njerëzimin, që bota islame të zgjohet dhe ky civilizim dështak, (që Njerëzimit i solli vetëm luftëra e shkatërrim, padrejtësi e hipokrizi, përparim teknologjik pa ekuilibër moral dhe stereotipe pa ujë fytyre, në fusha të ndryshme të jetës), të mbetet pjesë e së shkuarës së errët të njeriut që ia ktheu shpinën Zotit!

Ju ftoj të ktheni fytyrën nga Zoti, t'ia hapni derën e zemrës dhe t'ia dorëzoni atë, pa lejuar ndërmjetësinë e dikujt a ndërhyrjen abuzive, që e kthen njeriun në skllav të njeriut, jo në krijesën më të dashur të Zotit, të përlulur me dashni para Duarve të Tij!

Ju ftoj të paqtoni zemrat me njëritjetrin, të falni me dinjitet të afërmit tuaj, të forconi ndjenjën e besimit dhe të luteni për Rizgjimin e madh dhe Rimëkëmbjen e paevitueshme të Ymmit Islam, duke u lutur dhe punuar njëkohësisht për të qenë pjesë integrale e këtij procesi të bekuar, që ka në dorë shërimin e botës dhe kthimin e ditëve të saj në Bajrame!

Gëzuar Kurban Bajramin!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Mekë, Mina, 30 gusht 2017



"Dituria pa ndërgjegje

nuk është jetër,

vetëm se harab

(shkatërrim)

për shpirtin.

Dhe politika pa moral

nuk është jetër,

vetëm se harab

(shkatërrim)

për popullin".

Malik bin Nebij

(mendimtar algjerian, 1905 - 1973)

LUTJE MASIVE PËR PENDIM DHE FALJE NË TË GJITHA XHAMITË E SHKODRËS

Sikurse u lajmërua edhe më parë, ditën e xhuma, më 11 gusht 2017, në të gjitha xhamitë e Shkodrës tema e hytbes së kësaj jave u përqendrua tek aktualiteti dhe realitetet e përditshme shqiptare, ku përhapja e veseve, haramëve dhe imoralitetit përbën një shqetësim të madh.

Nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed B. Sytari dha një mesazh publik drejtuar krejt qytetarëve, për t'u kthyer nga besimi dhe feja, për të hapur një faqe të re në marrëdhënie me Zotin.

“Hapni sytë dhe pendohuni, kthehuni nga Zoti me një pendim të pakthyeshëm dhe deklaroni paqtimin me Zotin e botrave, për të dëshmuar kthimin e begatisë, qetësisë, sigurisë, mirëqenies e harmonisë në mes nesh!

Po humbet besimi në Zot, frika e Tij! Po kthehet e keqja në moral dhe morali në prapambetje! Po paragjykohe bijat tona për hixhabin e besimit dhe djemtë tanë për ruajtjen e nderit dhe distancimin nga haramet dhe ndalesat e shumta, që sot shiten si liri e nevojë e kohës!

Po nëpërkëmbet Zoti, feja dhe prindi! Po mohohet Zoti dhe po kërkohet të heshten minaret e besimit! Po vriten nana dhe baba, po mbytet gruaja dhe fëmija, po bekohet shthurja dhe devijimi në emër të vlerave evropiane! Vlerat tona ne i peshojmë me Kur'an dhe me udhëzimet e Hz. Muhamedit (a.s); po peshuan, mirë se të vijnë, e nëse jo, nuk hyjnë në sytë tanë, as duhet të lejohet përhapja e tyre në mes nesh! Vlerat i çmojmë me peshoren e besimit tonë, jo çfarë na jepet si kuti e dyllësor që duhet pranuar symbyllur!

Zgjohuni dhe hapni sytë! Mos lejoni që mbetjet e të tjerëve të na shiten për pasuri e nder! Mos lejoni që fëmijët t'jua

marrin për duarsh e t'jua konvertojnë në djaj të vegjël, që nesër do ta shkatërrojnë Shqipërinë, më shumë se ç'është shkatërruar e sflitur! Ne jemi muslimanë; e kemi të shenjtë fenë, jetën, mendjen, nderin dhe pasurinë! E kemi të shenjtë ta ndërtojmë jetën me vlerat e besimit tonë, sikurse e kemi të shenjtë ta ndalojmë të keqen dhe ta mbrojmë të mirën me krejt fuqitë që kemi!

Këto ditë kemi dëshmuar krime dhe vrasje, padrejtësi e zaptime, jemi përballur me zullume të panumërta në sakrificën tonë për ruajtjen dhe zhvillimin e pronave tona legjitime, si: në Zdralej, Zogaj, Qafë, Dudas e shumë e shumë vende të tjera, ku shohim neglizhencën e Bashkisë, Prokurorisë, Gjykatës, por jo vetëm, për të çuar në vend një hak të nëpërkëmbur prej dekadash..!?

Po ndjekim me shqetësim të madh përhapjen e zjarreve përreth Shkodrës dhe mbarë vendit, thatësi të kësaj stine, që e tejkalon natyrën e zakonshme të verës në vendin tonë, mungesën e reshjeve begatuese, shoqëruar me përhapjen në masë të alkoolit, muzikës shurdhuese pa asnjë kriter disiplinues, lakuriqësinë dhe përhapjen e imoralitetit, tradhtitë bashkëshortore dhe divorcet përherë e në rritje për shkak të devijimit nga besimi dhe morali i fesë, abortet abuzive dhe përhapjen e drogërave të ndryshme, kultivimin e bimëve narkotike dhe shtimin e fajdeve, përhapjen e injorancës dhe veshjen e saj me kollare e kostum, por jo vetëm kaq!”, tha ndër të tjera Myftiu.

Sikurse ishte lajmëruar, në fund të kësaj hytbeje, u bë edhe lutja masive për zbritjen e shiut dhe begatimin e vendit.

MYFTIU TAKON IMAMËT E QYTETIT NË PRAG TË KURBAN BAJRAMIT

Paraditën e së mërkurës, më 16 gusht 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e qytetit, me të cilët diskutoi aktivitetet e ditëve në vijim në prag të Kurban Bajramit 1438/2017.



Myftiu vlerësoi angazhimin e imamit të xhamisë së Kirasit, teologut Ruzhdi Plangaj, me trajnimin e haxhilerëve të rinj të këtij viti, sikurse lajmëroi se ditën e enjte, më 17 gusht 2017, ora: 20.00, pas namazit të akshamit, në oborrin e xhamisë Parrucë do të shfaqet dokumentari: “Rruga për në Mekë”.

Dokumentari në fjalë, prodhim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, është një përmbledhje mesazhesh dhe kujtimesh, emocionesh dhe nostalgjisë që lidhen me Haxhin e shqiptarëve dhe vlerat e këtij adhurimi të pashembullt.

Njëkohësisht informoi imamët, se ditën e xhuma, më 18 gusht 2017, në orën 12.45, në xhaminë e Parrucës do të nisë ceremonia e leximit të emrave të haxhilerëve shkodranë të këtij viti, shpërndarja e ihrameve, hytbeja e Myftiut dhe mesazhi i rastit, falja e xhumasë dhe përshëndetja me haxhilerët në oborrin e xhamisë Parrucë.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe programi i Kurban Bajramit të sivjetshëm në sheshin e Fushë Çelës, bri xhamisë “Ebu Bekër”, detajet e tij, ligjëruesit etj.

Myftiu falënderoi imamët për mendimet e vjera dhe diskutimet e rastit, sikurse u lut për mbarësi dhe suksese të vazhdueshme.

Të enjten, më 17 gusht 2017, pas namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, në vazhden e aktiviteteve që shoqërojnë trajnimin dhe përgatitjen e haxhilerëve shkodranë drejt vendeve të shenjta, Myftinia Shkodër organizoi shfaqjen e dokumentarit: “Rruga për në Mekë”.

Dokumentari në fjalë, prodhim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, u shfaq në oborrin e xhamisë së Parrucës, ku haxhilerë ndër vite, imamë e aktivistë të Myftinisë, drejtues të shoqatave islame dhe intelektualë, morën emocione të shumta përgjatë shfaqjes së tij.

Në hapje të aktivitetit, teologu Arben Halluni, shprehu falënderimet dhe urimet e Myftinisë Shkodër për haxhilerët e këtij viti, numri i të cilëve ia kalon viteve të shkuara.

Ai tha se Haxhi është një stinë besimi dhe adhurimesh, si dhe një mundësi e mrekullueshme përfitimi nga bekimet e All-llahut në Shtëpinë e Tij.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Të xhumanë, më 18 gusht 2017, në xhaminë e Parrucës u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së ihrameve të haxhilerëve shkodranë të këtij viti.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili tha se Islami është feja e krejt të dërguarve të All-llahut, si dhe balsami i munguar sot, për lëngatat e shoqërive njerëzore.

Myftiu dënoi edhe aktet terroriste të ditës së kaluar në Barcelonë, duke vënë theksin se Islami është feja e bardhësisë dhe ndërtimit të jetës me Dritën e Udhëzimit.

Hytbeja e kësaj jave dhe këshilla vjetore drejtuar haxhilerëve, u mbajt nga teologu Lavdrim Hamja.

Ai theksoi se Haxhi është një mundësi jete për të fituar bekimet e Zotit dhe xhennetin. Njëkohësisht tha se tubimi i miliona muslimanëve nga mbarë bota në një ditë të caktuar, në rituale të caktuara, mbetet një ndër dëshmitë më të mrekullueshme të forcës së besimit në jetën e njeriut.

Përshëndetja tradicionale me haxhilerët, pas namazit të xhumasë, mbetet një traditë e bukur e muslimanëve shkodranë, e trashëguar prej shekujsh.

U SHFAQ DOKUMENTARI: “RRUGA PËR NË MEKË”



CEREMONIA E SHPËRNDARJES SË IHRAMEVE





Sheikh Muhamed El-Gazali

Një djalë i ri erdhi të më pyeste për një mesele, në një çështje që i interesonte dhe më tha: A është e vërtetë, se ti, kur ke qenë drejtor për xhamitë, i ke këshilluar imamët, ndërkohë që po mbajnë hytben, të mos urdhërojnë askënd që është ulur ndejë të xhami, të mos çohet për të falur dy rekatë namaz, tehiyetul-mesxhid (përsëritja e xhamisë), e të mos urdhërojnë për tu ulur, ata që dëshirojnë t'i falin këto dy rekatë?

I thashë: Po, kush hyn dhe imami po mban hytben, ulet e ne nuk e urdhërojmë për asnjë gjë dhe kush fillon të falë dy rekatë namaz, e lëmë dhe nuk e ndalojmë për të. Nuk dua të nxis përçarje dhe as të ndez fitne!

Tha: Sikur ti, e miraton lënien e sunetit?

I thashë: Sikur të ishte konfirmuar se ato dy rekatë janë sunet, askush nuk do ta kishte lënë. Imam Maliku dhe Ebu Hanife janë të mendimit se është sunet dëgjimi me vëmendje i hatibit, ndërsa Imam Shafiu dhe Ahmed i mendojnë se është sunet, së pari të falen dy rekatë tehiyetul-mesxhid (përsëritja e xhamisë). Kështu që, njerëzit të zgjedhin çfarë të duan!!

Tha: Përse i barazove të dy mendimet?

I thashë: 99 % e hytbeve të Pejgamberit (a.s) kanë qenë Kur'an, që lexohej për namazlitë dhe dëgjimi me vëmendje i tij është vaxhib (detyrë). Imagjino, që i Dërguari i Allahut e urdhëroi atë njeri të falë namaz, pastaj vazhdoi në hytben e tij.. është e palogjikshme, sepse ne kur mbajmë hytbe besojmë se të gjithë duhet të na dëgjojnë, e jo të na dëgjojnë një pjesë dhe të tjerët të falen!! Kush e ka pranuar hadithin e transmetuar për këtë çështje, ka thënë që, ai është sipas shprehjes së juristëve (fukahave)

RRETH KUPTIMIT TË SUNETIT

situatë e rastit, apo çështje e veçantë. Ai njeri ishte në një gjendje të dhimbshme dhe Pejgamberi (a.s) kishte dëshirë të tërhiqte vëmendjen e të tjerëve, në mënyrë që t'i jepnin sadaka (lëmoshë), përndryshe urdhri i përgjithshëm është që të pranishmit të dëgjojnë hytben..!

Djaloshi tha: Këto fjalë janë të papranueshme. Nuk i takon Imam Malikut dhe Ebu Hanifes të refuzojnë një sunet të konfirmuar!

I thashë: Nuk ka asnjë mysliman, që refuzon një sunet të konfirmuar. Kundërshtimi a është sunet? I kam lënë të dy mendimet e përhapura ndër njerëz, kush dëshiron falet dhe nuk e urdhëroj të ulet, e kush dëshiron ulet ndenjor dhe nuk e urdhëroj të ngrihet e të falet!! Nuk lejoj potere në xhami! Nëse i Dërguari ynë na ka mësuar se muxhtehidi (interpretuesi) është i shpërblyer, gaboi apo ia qëllloi, atëherë përse t'i them atij që mendoj se është i gabuar: Qofsh i mallkuar dhe nuk do të lë ta shikosh mendimin tënd! Unë zbatoj fjalën e Tij (xh.sh): "Dhe, mos u bëni si ata, të cilët u përçanë e u konfliktuan, pasi që u erdhën sqarimet".

Mbeta i befasuar prej djaloshtit, që më thoshte: Ju talleni me sunetin!

I thashë: Bashkoju xhematit, në atë që mbledh çështjen e myslimanëve dhe lufto nën flamurin e tyre! Ndërsa, kur mendimet ndryshojnë, mos përhap fitne dhe të fanatizohesh ndaj një medhhebi të veçantë, sepse të tërë myslimanët janë vëllezër!

* * *

Një djalë tjerë më tha: Përse i mbani hytbet nëpër xhamia në minbere, që ndoshta ndonjë prej tyre arrin nëntë shkallë, duke ditur se minberi i hytbes në kohën e Pejgamberit (a.s), nuk ka qenë më i lartë se tre dhëmbë shkallë?

E shikova për pak çaste, pastaj i thashë: E, përse faleni në xhaminë e shtruar me tapet, apo me diçka tjetër, ndërkohë që në kohën e Pejgamberit (a.s) ka qenë e shtruar me rrogoza, apo me dhë?

Transmeton Buhariu se Pejgamberi (a.s) duke kërkuar Natën e Kadrit, ka bërë sexhde në ujë dhe baltë, sepse ra shi dhe xhamia nuk kishte çati, siç ka sot!

Çatia e saj ishte prej degëve të hurmave (palmave), dhe a është sunet t'i heqim tapetat prej xhamive, e t'ia

kthejmë degët e hurmave dhe trungjet e tyre?

O ti djalë, e shembuj të tjerë si ti, ju nuk arrini ta kuptoni fenë, e as dynjanë. Mendimet tuaja fëminore për Islamin dhe jetën, nuk i shërbejnë, përveçse armiqve të Islamit. Më ka gëzuar pa masë zgjerimi i fundit i dy Haremeve të Shenjta dhe dëshiroja që mermeri i shtrenjtë t'i kishte shtruar të gjitha Shtëpitë e Allahut, e minberet të lartësoheshin si kulla, duke pushtuar horizontet me tekbiere dhe teuhid.

**UNË SHPRESOJ QË
MYSLIMANËT TA KENË TË QARTË
SE ÇFARË KANË PËRPARA TYRE.
NDOSHTA DIKUR KEMI MBYLLUR
SYTË NDAJ DISA NDASIVE
MEDHHEBORE, NDËRSA NXËNIA
E MYSLIMANËVE TASHI,
ME KËTO NDASI, ATO NUK KRYHEN,
VETËM SE, PËR LLOGARI TË
SIONIZMIT DHE KOLONIZIMIT.**

Mirëqenia, madhështia dhe bukuria janë të kërkuara në arkitekturën e objekteve të kultit, shkollat e dijes dhe dispozitat e vërteta. Kur mbaja hytbe në Universitetin e Ez'herit, ndjeja kënaqësi, sepse unë shikoja safat (rreshtat) përpara meje dhe e shikoja gjendjen e dëgjuesve..

E megjithatë, kryesorja është sundimi i rrymës së besimit, dëgjimi i të pranishmëve, bashkimi i rreshtave në unitet dhe vëllazëri dhe gatishmëria e tyre për sakrificë e vetëmohim. Asgjë prej saj nuk mund të arrihet, vetëm se me gumëzhitjen e Kur'anit në zemra, lidhjen e ymetit me historinë dhe trashëgiminë e vet dhe rendjen e tij në fushat e punës me seriozitet..

Unë shpresoj që myslimanët ta kenë të qartë se çfarë kanë përpara tyre. Ndoshta dikur kemi mbyllur sytë ndaj disa ndasive medhhebores, ndërsa nxënia e myslimanëve tashi, me këto ndasi, ato nuk kryhen, vetëm se, për llogari të sionizmit dhe kolonizimit.

*Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:*

Lavdrim Hamja

Të shtunën, më 19 gusht 2017 është nisur grupi i parë i besimtarëve muslimanë nga Shqipëria që udhëtojnë drejt vendeve të shenjta, në Mekë dhe Medinë për të kryer kushtin e pestë të shtyllave të Islamit, obligimin e Haxhit.

Këtij grupi haxhilerësh të siviljetshëm u janë bashkuar 42 besimtarë nga Shkodra, një numër më i lartë se vitet e tjera, të cilët u përçollën nga familjarët e tyre, të afërm, nga besimtarë të shumtë si dhe nga përfaqësues të Myftinisë Shkodër.

Besimtarë të shumtë dhe familjarë e të afërm të haxhilerëve të këtij viti, kishin mbushur oborrin e xhamisë së Parrucës, të cilët kishin dalë për të përcjellë e për të uruar vëllezërit dhe motrat e tyre, që po niseshin për "Udhëtimin e jetës", kryerjen e një obligimi të madh dhe shtyllë e Islamit, obligimin e Haxhit.

Si çdo vit, Myftinia Shkodër kishte organizuar nisjen e haxhilerëve shkodranë me autobus drejt aeroportit të Rinasit, ku më pas do të bashkoheshin me haxhilerët e tjerë Shqiptarë, për të vazhduar rrugëtimin drejt më të shenjtës tokë në rruzull, Qaben e Madhërueshme.

Haxh dhe lutje të pranura për të gjithë haxhilerët e mbarë botës islame!

42 HAXHILERË NGA SHKODRA U NISËN KËTË VIT PËR NË TOKAT E SHENJTA!...



Ditën e enjte, më 17 gusht 2017 dhe ditën e xhuma, më 25 gusht 2017, në ambientet e xhamisë së Parrucës përfaqësuesit e Myftinisë Shkodër, teologët Arben Halluni dhe Lavdrim Hamja pritën një grup studentësh, seminaristë katolikë të Milanos, nën drejtimin e Don Maurizio Cacciola dhe të disa priftërinjve nga Italia. Qëllimi i vizitës së tyre ishte për të njohur nga afër Islamin, aktivitetet e Myftinisë, rreth riteve fetare që kryhen në xhami, harmoninë, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërfetare në Shkodër etj.

Teologu Halluni pasi i falënderoi miqtë për vizitën e tyre në xhami, bëri një përmbledhje të shkurtër rreth Islamit dhe adhurimeve të tij.

Në bisedën e ngrohtë me miqtë e ardhur nga Milanoja e Italisë, tha se qyteti i Shkodrës quhet ndryshe me krenari edhe qyteti i harmonisë dhe i tolerancës, për faktin se kjo vlerë e madhe e popullit shqiptar preket kudo: në familje, shoqëri, në mes besimtarëve pa dallim feje, në mes të drejtuesve fetarë etj.

Ndër të tjerë, teologu Halluni u shpreh se është amanet nga të parët tanë dhe për më tepër të udhëzuar nga mësimet islame, që ta ruajmë dhe

NJË GRUP STUDENTËSH, SEMINARISTË KATOLIKË TË MILANOS VIZITOJNË XHAMINË E PARRUCËS



promovojmë sa më shumë këtë harmoni dhe mirëkuptim ndërfetar që e përjeton Shkodra dhe mbarë Shqipëria.

Gjatë bashkëbisedimit u bënë edhe pyetje nga studentët seminaristë rreth rritit të namazit dhe lutjes islame, rolin e xhamisë, misionin e imamit etj. Sikurse u bashkëbisedua për vizitat reciproke midis përfaqësuesve të bashkësive fetare në vendet respektive me synim të forcimit të lidhjeve miqësore midis tyre dhe

bashkëpunimit për çështje të ndryshme si sociale, kulturore, etj.

Vizitat e seminaristëve katolikë nga Italia dhe shtete të tjera të Evropës në institucionet fetare të Shkodrës do të zhvillohen edhe në të ardhmen, duke u parë nga vizitorët e huaj si vend për t'u marrë shembull konkret i tolerancës dhe harmonisë ndërfetare të ruajtur e kultivuar ndër shekuj.

MADHËSHTIA E NJË FESTE QË NA NDËRGJEGJËSON...!





Durim Kasemi
Imam, xhamia Parrucë

Haxhi është adhurimi që ngjallë ndjenjat e mallit, dashurisë dhe përkushtimit në zemrën dhe shpirtin e çdo besimtari. Allahu e ka obliguar atë një herë në jetë për çdo person që ka mundësi ekonomike dhe fizike për ta kryer por, duke ditur kushtet ekonomike (kryesisht) dhe rrethanat në të cilat jetojmë, kryerja e këtij adhurimi nuk është e mundur për shumicën prej nesh, edhe pse me zemër të gjithë do donim të ishim në Mekke bashkë me haxhilerët e tjerë.

Kryerja e haxhit ka shpërblim shumë të madh tek Krijuesi. Thotë Pejgamberi (a.s): “Kushdo që e bën haxhin të plotë dhe pa gjynahe (fjalë dhe vepra të ndaluara) do të kthehet prej atje sikur atë që e ka lindur nëna”. – (Muslim: nr.1350) Kush nuk do ta dëshironte këtë shpërblim dhe këtë vlerësim!? Çdo besimtar pa përjashtim, sepse falja e gjynaheve është dëshira parësore e çdonjërit prej nesh!

Allahu, Krijuesi ynë dhe i gjithësisë, është më i mëshirshëm me ne, se sa ne për vetet tona, prandaj, prej shenjave të mëshirës e mirësisë së Tij ndaj nesh, janë edhe disa punë të mira, të cilat e kanë shpërblimin e haxhit. Në lidhje me këtë kanë ardhur shumë hadithe, por vetëm disa prej tyre janë të saktë. Këto hadithe flasin për gjashtë vepra të mira që kanë shpërblimin e haxhit dhe këto vepra janë:

1. NIJETI I SINQERTË PËR TA KRYER HAXHIN

Pejgamberi (a.s) na ka mësuar se veprat e njeriut vlerësohen sipas qëllimit të tyre dhe nisur nga kjo nëse muslimani në zemrën dhe mendjen e tij e ka për qëllim me sinqeritet të plotë kryerjen e haxhit sapo t'i jepet mundësia, ose sikur të kishte mundësi të shkonte, do e kryente dhe nuk do ngurronte, Allahu i Gjithëmëshirshëm këtij personi

GJASHTË VEPRA QË KANË SEVAPIN E HAXHIT

ia shkruan sikur të ketë bërë haxhin.

Pejgamberi (a.s) thotë: “Në dynja njerëzit ndahen në katër lloje... (do përmend vetëm dy që kanë të bëjnë me pikën e parë): “(lloji i parë) Njerëz që Allahu iu ka dhënë pasuri dhe dije, të cilët i zbatojnë detyrimet ndaj Allahut në lidhje me të (pasurinë) dhe i mbajnë lidhjet farefisnore. Këta janë në pozitën më të lartë. (lloji i dytë) Njerëz që Allahu iu ka dhënë dije, por jo pasuri por, që kanë qëllim të pastër dhe të sinqertë dhe thonë: Sikur të kishim pasuri do të vepronim sikur filani (ai që ka dije pasuri). Këta njerëz kanë shpërblimin sikur t'i kishin vepruar ato punë dhe të njëjtë me ata që i kanë bërë”. - (Ahmedi: nr.18031, hadith hasen)

2. THËNIA “SUBHANALLAH”, “ELHAMDULILAH” DHE “ALLAHU EKBER” PAS NAMAZEVE FARZE

Dhikri pas namazeve farz, edhe pse një punë që kërkon pak mund dhe kohë, ka shpërblim shumë të madh siç ka ardhur në shumë hadithe. Një ndër shpërblimet e shumta është edhe shpërblimi me vlerën e haxhit për atë që thotë pas çdo namazi farz, 33 herë Subhanallah, 33 herë Elhamdulilah dhe, 34 herë Allahu ekber.

Lidhur me këtë sahabiu Ebu Derda (r.a) shkoi tek Pejgamberi (a.s) dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, të pasurit morën gjithë shpërblimin! Ata bëjnë haxh kurse ne jo! Ata luftojnë kurse ne nuk kemi mundësi të luftojmë me atë çka luftojnë ata (pra me pasurinë e tyre duke dhënë sadaka për mbrojtjen dhe përhapjen e fesë)! Pejgamberi i tha: Nëse dëshiron, do të tregoj diçka që nëse e veproni do të merrni shpërblim më shumë se ata që përmende! Thoni 34 herë Allahu Ekber, 33 herë Subhanallah, 33 herë Elhamdulilah, pas çdo namazi farz”. – (Ahmedi: nr.27515, hadith sahih)

Nga ky hadith kuptojmë se ai që i thotë këto dhikre sikur na ka mësuar Pejgamberi, ka shpërblimin sikur të ketë bërë haxhin dhe, sikur të ketë shpenzuar pasurinë e tij për mbrojtjen dhe përhapjen e fesë.

3. BËRJA E UMRES NË MUAJIN E RAMAZANIT

Kryerja e Umres në çdo kohë ka

“Kush e fal NAMAZIN E SABAHUT ME XHEMAT, PASTAJ ULET DHE E PËRMEND ALLAHUN DERISA TË LIND DIELLI E PASTAJ NGRIHET DHE fal dy REKAT, do i shkruhet si shpërblim sikur të ketë kryer një haxh dhe një umre të plota, të plota, të plota”

shpërblim të madh, por nëse kësaj i shtohet koha e veçantë në të cilën kryhet, këtij ibadeti i shtohet shpërblimi më tepër madje, mund të ketë edhe shpërblimin e haxhit, sidomos nëse kryhet në muajin e Ramazanit.

Për këtë Pejgamberi (a.s) kur është pyetur se në cilin muaj është më mirë të bëhet Umreja, ai është përgjigjur: “Bëje Umren në muajin e Ramazanit, sepse Umreja në këtë muaj, e ka shpërblimin sikur një haxh”. – (Ahmedi: nr.17600, hadith sahih)

4. FALJA E NAMAZIT TË SABAHUT ME XHEMAT DHE QËNDRIMI NË XHAMI DERISA TË LIND DIELLI DHE FALJA E DY REKATËVE NAMAZ

Koha e namazit të sabahut, përpara dhe pas tij, është një pjesë shumë e bereqetshme e kohës por, që shumë prej nesh nuk e shfrytëzojnë siç duhet, edhe pse nuk kemi asnjë angazhim përveç gjumit. Ngritja nga gjumi në këtë kohë dhe falja e namazit të sabahut i sjell njeriut mbrojtjen e Allahut dhe bereqetin e Tij. Këtyre mirësive i shtohet edhe sevapi i haxhit dhe umres nëse rrihet në xhami derisa të lind dielli dhe, të përmendet Allahu në këtë kohë e pastaj të falet namazi i Duhasë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj ulet dhe e përmend Allahun derisa të lind dielli e pastaj ngrihet dhe fal dy rekat, do i shkruhet si shpërblim, sikur

të ketë kryer një haxh dhe një umre të plota, të plota, të plota!” – (Sahih Ettergib ue Etterhib: nr.467)

5. PREZANTIMI NË TUBIMET KU MËSOHET FEJA NËPËR XHAMIA

Vlera e dijes vjen nga tema që shtjellon dhe trajton siç edhe kanë thënë hoxhallarët e nderuar. Nisur nga kjo, dija fetare është ajo më me vlerë sepse ajo mëson për Allahun, Krijuesin e gjithësisë dhe Zotëruesin e çdo gjëje, burimin e çdo mirësie. Mëson për Profetin (a.s), njeriun më të mirë të krijuar nga Allahu Fuqiptotë. Padyshim që edhe shpërblimi për mësimin e këtyre dijeve është shumë i madh. Ata që thyjnë gjunjët e tyre për të mësuar fenë e Allahut dhe për t'ia mësuat atë të tjerëve, Allahu ju dhuron mirësi të shumta, një ndër këto mirësi është edhe sevapi i kryerjes së haxhit.

Pejgamberi (a.s) ka thënë se: “Kushdo që shkon në ndonjë prej xhamive me qëllim për të mësuat fenë e Allahut, apo për t'ia mësuat atë të tjerëve, do të ketë shpërblimin sikur të ketë bërë haxhin e plotë”. – (Sahih Ettergib ue Etterhib: nr. 86)

Sikur të mos kishte asnjë përfitim tjetër prezantimi i mexhliseve të dijes, Kur'anit, hadithit, sires dhe lëmvive të tjera të fesë, ky do të ishte i mjaftueshëm për të motivuar çdo musliman që synon mëshirën dhe faljen e Allahut në dy botët, edhe pse sevapet e kësaj vepre janë shumta.

6. FALJA E NAMAZAVE FARZ NË XHAMI

Shumë dijetarë mendojnë se falja e namazit me xhemat është farz (obligim). Kjo na detyron të ndalemi pak dhe të mendojmë rreth raportit tonë me namazet me xhemat në xhami. Edhe po të mos jetë farz, që nënkupton mosndëshkimin për moskryerjen e kësaj vepre, duhet shikuar ana tjetër e kësaj vepre: Shpërblimi (sevapi) dhe mirësia e pakrahasueshme që ka namazi me xhemat në xhami. Një ndër shpërblimet që merr muslimani nëse e bën këtë vepër, është ai i të kryerit të haxhit.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kushdo që del nga shtëpia i pastruar (me abdes) për të shkuar në xhami për namazin farz, shpërblimi i tij është sikur i haxhiut që ka bërë haxhin”. – (Ebu Davudi: nr.558, hadith hasen)

VDEKJA, KY ÇAK I PAEVITUESHËM DREJT SË PËRTEJMES..!

Lexova sot, një fjalë të presidentit turk, Rexhep Taip Erdoğan, ku në mes të tjerave thoshte: “Presidenti i Republikës dhe kushdo tjetër, do të vdesë; nesër, a pasnesër, a në një kohë tjetër! Do të varrosem në një varr të ngushtë dhe do ma thërrasin emrin (gjatë telkinës), të zhveshur nga emërtesat, posti dhe gradët! Prandaj, duhet të bëjmë vepra të mira dhe të jemi të thjeshtë!”

Kjo shprehje e tij më solli ndër mend porosinë e madhe, që na e përkujton Resulull-llahu (a.s), kur thotë: “Shtojeni përkujtimin e asaj që ju prish kënaqësitë (e kësaj bote kalimtare); vdekjes!”

Kur'ani na mëson: “Ti (o Muhammed) do të vdesësh, edhe ata do të vdesin!”, sikurse na udhëzon se: “Kudo që të jeni, ju arrin vdekja!”... Me fjalë të tjera, askush prej nesh s'i shpëton dot vdekjes, sikurse: “... askush s'e di se ku do të vdesë”, siç përmendet në fjalën e Zotit.

Dje pasdite, isha aty, kur u rivarros i madhi dijetar e atdhetar i kombit, Hafiz Ali Korça. Ndjeva një peshë të rëndë mbi supe, teksa shoqëroja eshtrat e tij, ndonëse ato mund t'i ngrinte kushdo pa asnjë sforcim fizik... Peshonin sa krejt madhështia e emrit të tij me tre harfe të bukura..., sa vepra e tij e heshtur librave..., sa emri i tij i përdorur aty-këtu, herë me vend e herë pa vend, sa historia e tij (e keqlexuar), sa koha e tij, ku dijetarë e atdhetarë të shquar të këtij kombi nuk fshiheshin pas perdeve të frikës, por e thonin fjalën e tyre, tamam si vargjet e “Shtatë ëndrrave të Shqipnisë”, që akoma kanë nevojë për një Hamzade për t'i interpretuar e kuptuar në raport me greminën ku është katandisur atdheu ynë, trojet etnike,

kombi dhe ajo çfarë shihet në horizont...

Ndërkohë sot, vizitova varrezat e qytetit tim, ku pushojnë në qetësinë e painterpretueshme të atij vendi, sa e sa të njohur dhe të panjohur, të ditur e të paditur, të rinj e të moshuar, fëmijë e të posalindur... Të gjithë ata, sot janë thjeshtë një kujtim, një emocion, një lot, një lutje, një dhembje, një mungesë, një fjalë e pathënë, një ëndërr e perealizuar, një emër i gdhendur në një gur pa shpirt, që ruan në memorie një botë të madhe sa shpirti i të zotit, emrin e të cilit ruan me besnikëri...

Vizitova edhe nanën me gjyshin, axhën, por jo vetëm... Përballë tyre, teksa lutesha e këndoja një “Fatiha”, m'u kujtuan gurët e varreve në Zogaj, ku gjithandej lexohet: “Ne ishim si ju, edhe ju do të bëheni si ne!”... Është mirë t'i vizitosh të shkuarit... Ta thjeshtësojnë rrugën...

Ia vlen ta mendosh se, një ditë, krejt papritur e pamenduar, do të largohemi nga kjo botë, pa poste, pa llagepe, pa pasuri, pa të dashurit e zemrës, pa asgjë..., tamam si atë ditë, kur erdhëm në këtë botë kalimtare.

Ia vlen ta mendosh, për atë që vjen pas, për llogarinë, për të përtejmen e përjetshme, për rikthimin në origjinë...

Dhe, siç shkruhet në urtësitë arabe: “Kur isha i vogël, përfytyroja se vdekja merr vetëm gjyshërit. U rrita. Nisa ta shoh të merrte më të vegjël se mua, teksa më kalonte pranë..! Sikur më pëshpërinte në vesh: Do të kthehem një ditë edhe tek ti, përgatitu!”

Vdekja, ky çak i paevitueshëm drejt së përtejmes..!

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 9 gusht 2017





Idmir Plaku
Imam, xhamia "Ebu Bekër"

Dita e Arafatit është një nga ditët me vlerë të veçantë në jetën e kësaj bote. Mirësitë e saj janë të shumta, por le të përmendim disa prej tyre:

1- Ajo është dita e plotësimit të fesë dhe e përbushjes së mirësisë së Allahut ndaj besimtarëve. Allahu (xh. sh) thotë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe". – (El-Maide: 4) Ky ajet kuranor ka zbritur në Haxhin e Lamtumirës dhe ka qenë ditë e xhuma. Disa nga brezi i parë i besimtarëve kanë thënë se, nëse dita e Arafatit bie në ditën e xhuma, Allahu (xh.sh) falë mëkatet e gjithë të pranishmëve në Arafat. Ithtarët e librit ka thënë sikur ky ajet kuranor do të kishte zbritur tek ne, atë ditë do ta bënim festë. Ndërsa Umer ibën Hatab (r.a) ka thënë dëshmoj se ky ajet ka zbritur në dy ditë feste, ditën e Arafatit dhe që ka qenë e xhuma e Pejgamberi (a.s) ka qenë në Arafat.¹

PLOTËSIMI I FESË NË KËTË DITË NDODHI NË DISA ASPEKTE:

Së pari besimtarët nuk kishin kryer Haxhin pasi ishte bërë obligim dhe me këtë shtyllë plotësohej Islami. Së dyti Allahu (xh.sh) e riktheu ritin e kryerjes së Haxhit mbi bazat e Ibrahimit (a.s), mohoi shirkun dhe njerëzit e tij dhe nuk lejoi që në tubimin e Arafatit të jenë të pranishëm. Dhe së treti në atë ditë u arrit mirësia e faljes së mëkateve, meqë mirësia nuk përbushet vetëm falë saj. Sikurse Allahu (xh.sh) i tha Pejgamberit (a.s): "Ashtu që All-llahu (pas fitores) të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme (kur njerëzit do të pranojnë fenë islame dhe nuk do të jenë më mëkatarë) dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje në rrugën e drejtë". – (El-Feth: 2)

1.1-Ibën Xherir në tefsirin e tij 9/525

VLERA E DITËS SË ARAFATIT

2- Madhësinë dhe vlerën e kësaj dite Allahu (xh.sh) e ka treguar në betimin e tij hyjnor ku thotë: "Pasha agimin, pasha dhjetë netët, pasha çiftin dhe pasha tekun". – (El-Fexhër: 1-3) Në këtë ajet kuranor Ibën Abazi (r.a) thotë: "Dita teke është ditë e Arafatit dhe ajo çift, është dita e Kurbanit. Po kështu Allahu (xh.sh) është betuar përsëri duke thënë: "Pasha atë që dëshmon dhe atë që dëshmonet". – (El-Buruxh: 3) Ndërsa në këtë ajet dita "që dëshmon" është dita e Arafatit. Në lidhje me këtë Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Ajo që dëshmon është dita e Arafatit, ndërsa ajo që dëshmonet është dita e xhuma."² Dita e Arafatit është një nga ditët më të mira të vitit. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Dita më e mirë është dita e kurbanit pastaj dita e Arafatit."³

3- Në ditën e Arafatit Allahu (xh.sh) mori besën nga bijtë e Ademit (a.s). Transmetohet nga Ibën Abazi (r.a) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Vërtetë që Allahu (xh.sh) nxori nga shpina e bijve Ademit (a.s) pasardhësit e tyre dhe u foli, siAllahu (xh.sh) thotë: "Përkujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuës të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Zoti juaj?"Ata thanë: "Po dëshmuam!" Të mos thoni në ditën e kiametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur. Ose të mos thoni: "Prindërit tanë më parë ishin idhujtarë, e ne ishim pasardhës të tyre. A do të na shkatërrosh ne për atë që bënë ata asgjësues të së vërtetës?" – (El A'raf: 172-173)

4- Në ditën e Arafatit Allahu (xh.sh) mburret me banorët e tokës përpara banorëve të qiellit. Ibën Umeri (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Vërtetë në ditën e Arafatit Allahu (xh.sh) zbret në qiellin e dynjasë dhe mburret me banorët e tokës përpara banorëve të qiejve duke thënë: "Shikojini robërit e Mi! Më kanë ardhur flokëshprishur nga të gjitha vendet e largëta dhe i janë ekspozuar diellit.....".⁴

5- Nuk ka ditë që më së shumti Allahu (xh.sh) liron njerëz nga zjarri sesa në ditën e Arafat.

2.2-Nga Ebu Hurerje, Taberij në El-Kebir 3/298
3.3-Ahmedi ne Musned
4.4- Ahmedi

ÇFARË ËSHTË E PËLQYER NË DITËN E ARAFATIT?

Vëlla besimtar!

Nëse synon që t'i largohesh zjarrit e të jesh faqebardhë ditën e shpërblimit para Allahut, vlerësoje këtë ditë duke punuar vepra të mira. Prej këtyre veprave si:

AGJËRIMI I KËSAJ DITE.

Është e pëlqyer agjërimi i ditës së Arafatit për atë që nuk është duke bërë Haxhin.

Transmetohet Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Agjërimi i ditës së Arafatit shpresoj tek Allahu (xh.sh) të shlyejë mëkatet e vitit të kaluar dhe vitit që vjen, ndërsa agjërimi i ditës së Ashures shpresoj tek Allahu të shlyejë mëkatet e vitit të kaluar". Në lidhje me këtë hadith imam Menavi, (Allahu e mëshiroftë) agjërimi i ditës së Arafatit është suneti i Muhamedit (a.s) kurse agjërimi i ditës së Ashures, suneti i Musait (a.s). Si vërehet vlera e synetit të Muhamedit (a.s) është e dyfishtë ndaj sunetit të Musait (a.s).⁵

SHQIPTIMI SA MË SHUMË E ME SINGJERITET I DËSHMISË SË SHEHADETIT.

Kjo është esenca e fesë Islame të cilën Allahu (xh.sh) e përsosi në këtë ditë.

TË BËRIT LUTJE DHE TË KËRKUARIT FALJE ALLAHUT .

Kjo ditë është ditë e pendesës, përluljes, frikës së robrit, faljes, dëgjësës dhe e përgjigjes së Allahut. Transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Lutja më e mirë është lutja në Arafat. Lutja më e mirë që kam thënë unë dhe të dërguarit para meje: "S'ka Zot tjetër, përveç Allahut, që është i Vetëm, i Pashoq. Atij i takon sundimi dhe falënderimi dhe është i Plotfuqishëm mbi do gjë".⁶

Së fundmi lusim Allahun e madhëruar që të jemi prej besimtarëve që vlerësojë atë çfarë Allahu e ka madhëruar dhe na përfshin në mëshirën e kësaj dite të madhe.

5.5-Fejdu Kadir 4/211
6.6-Tirmidhi



Lavdrim Hamja,
imam - xhamia e "Dy Vajzave"

OAllah i Madhëruar, Ty të takon falënderimi, siç e meriton Madhëria Jote, ne kurrë nuk mund të Të lavdërojmë e të Të madhërojmë, siç e meriton Ti të lavdërohesh e të madhërohesh.

Salavatet dhe selamet, paqja dhe shpëtimi i plotë qoftë për mbi vulën e gjithë Profetëve të Zotit, Muhammedin (a.s), të cilin Allahu i Madhëruar, nuk e dërgoi ndryshe, vetëm se mëshirë për mbarë botët. Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë për mbi të gjithë Profetët e tjerë të Zotit, që nga Ademi (a.s) e deri te Isai, i biri i Merjemes (a.s).

Paqja dhe shpëtimi i Zotit, qoftë për mbi mbarë shokët e Profetëve dhe besimtarët e singertë deri në Ditën e Kiametit.

Allahu Ekber, i Cili është krijuesi i gjithësisë dhe Zoti i saj.

Allahu Ekber, i Cili është Një dhe i Vetëm.

Allahu Ekber, i Cili e krijoi njeriun dhe i dërgoi Profetë për ta udhëzuar.

Allahu Ekber, për çdo mirësi që na ka dhënë, sidomos mirësinë më të madhe duke na bërë besimtar.

Allahu Ekber, për çdo zullumqar, që sado të jetojë, patjetër do të dalë para Zotit dhe do të përgjigjet për zullum që ka bërë.

Allahu Ekber, për këdo që mundohet t'i largojë njerëzit nga rruga e besimit dhe mundohet me gjithfarë mënyrash ta prishë imazhin e Islamit dhe të myslimanëve, me akuza dhe trillime të pavërteta.

Allahu Ekber, për çdo besimtar, që sado të persekutohet në këtë botë për besimin e tij, patjetër një ditë do të triumfojë, se Zoti nuk ia humbë mundin askujt.

Allahu Ekber, për çdo jobesimtar, që sado të mashtrohet në këtë jetë, e

ALLAHU EKBER, PËR ÇDO BESIMTAR, QË PERSEKUTOHET PËR BESIMIN E TIJ...

sado të mendojë e të besojë se nuk do të vdesë, patjetër do të vdesë një ditë e do të dalë përpara Zotit të tij, e do të japë llogarinë absolute.

Allahu Ekber, i Cili e bëri njeriun mëkëmbës në tokë dhe ia ngarkoi amanetin e ruajtjes së rendit në të, por ky njeri po i bën zullum vetes së tij, duke dalë e devijuar jashtë rrugës së drejtë të Zotit dhe kjo gjë i ka shkakuar, po i shkakton dhe do t'i shkaktojë shumë dhimbje e mundime. Pikërisht, ashtu siç thuhet në Kur'anin Famëlartë: "O ju njerëz! Pa dyshim, që mosbindja juaj, bie mbi kokat tuaja. Kënaqësi e jetës së kësaj bote, pastaj tek Ne është kthimi juaj, e do t'ju lajmërojmë për atë se çka keni punuar". - (Junus: 23)

Të nderuar vëllezër dhe motra besimtarë,

Kjo ditë e madhërueshme, e festës së Kurban Bajramit, simbolizon një sakrificë shumë të madhe dhe sublime. Historia e babit të Profetëve, Ibrahimit (a.s) për të sakrifikuar të birin e tij, Ismailin (a.s), dhe zëvendësimi i kësaj bindjeje me therjen e një bagëtie kurban, sikur do të na thotë se kjo botë nuk vlen asgjë përpara botës tjetër, të përtejme dhe të përhershme dhe kushdo që i bindet Zotit të gjithësisë e Krijuesit të Plotfuqishëm, Ai i Madhërueshmi, përveç shpërblimit të bindjes ndaj Tij, ia zëvendëson çdo sakrificë të kësaj bote, me të mira e begati, të pakufishme. Pikërisht, kështu thotë në Kur'anin Famëlartë, Zoti i Madhëruar: "Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, i frikësohet Allahut dhe është i devotshëm ndaj Tij, të tillët janë shpëtuarit". - (En-Nur: 52)

Nuk ka dyshim se, bota sot, ka më shumë nevojë se asnjëherë tjetër për mësimet hyjnore dhe udhëzimin e Kur'anit Famëlartë, Fjalës së Zotit të gjithësisë, e Krijuesit të Përsosur. Historia njerëzore e kësaj bote, që nga Ademi (a.s), e profet pas profetit, deri tek Profeti i fundit, Muhammedi (a.s) na mëson se, sa herë që njerëzimi ecë në rrugën e profetike të të Dërguarve të Zotit, jeton në paqe e në harmoni me vëllanë e tij njeri dhe sa herë që njerëzimi ka devijuar dhe devijon prej kësaj rruge, marrëzia dhe çmenduria njerëzore nuk ka njohur kufij. Luftëra të tëra e gjakderdhje makabre janë shkakuar prej njeriut që nuk njeh Zotin dhe nuk beson në të.

Po të llogarisim bilancin tragjik të luftërave botërore, shkaqet dhe pasojat e tyre, patjetër do të bindemi se, kur njeriu nuk njeh Zotin e Tij, bën shkatërtime e krime makabre, që as vetë djalli e shejtani, nuk i bën të tilla krime. Miliona, e miliona të vrarë prej dy luftërave botërore, e Zoti na ruajt, që të mos ndodhë ndonjë konflikt tjetër botëror.

Edhe sot që po flasim në këtë ditë të bekuar e të madhërueshme, përpara syve të mbarë botës së qytetëruar, po ndodhin masakra, persekutime dhe krime çnjerëzore ndaj popullsisë myslimane në Ruanda. Ata nuk po persekutohen për diçka tjetër, vetëm se janë njerëz që besojnë në një Zoti të Vetëm. Tamam ashtu siç thotë Zoti në Kur'anin Famëlartë: "Dhe nuk hakmerreshin ndaj tyre, përveç se besuan në Allahun e Madhëruar, e të Falënderuar. Të Cilit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Allahu për çdo gjë është Dëshmitar". - (El-Buruxh: 8-9)

O Zot i gjithësisë, mbroje këtë qytet, e këtë vend prej dashakeqësve, të cilit nuk ia duan të mirën. Mbroje këtë qytet, e këtë vende, prej provave e fatkeqësive të ndryshme.

O Zot i Madh, udhëzoji pushtetarët, drejtuesit dhe politikanët, të Shkodrës e të Shqipërisë, që të punojnë për të mirën e popullit dhe të ardhmen e tij.

O Zot i Madhëruar, jepi mirësi dhe begati secilit prej nesh dhe na bëj prej atyre, që punojnë mirë, sillen mirë, kanë moral të mirë dhe udhëzojnë për më të mirën.

O Zot i Lartë, Ti që je Krijuesi dhe Furnizuesi i çdo krijese, jepi përkrahjen Tënde e rrisht të bollshëm, çdo njeriu në nevojë e të varfër. Çdokush që halle, telashe, e borxhe, bëju Ndihmës dhe Mbështetës për të, ja Rabbet-alemin.

O Allah, Ti që je Zoti i të gjithëve, Një dhe i Vetëm, ne të lutemi për paqen, sigurinë dhe harmoninë në mesin tonë, në qytetin tonë, në vendin tonë, e në mbarë botën, ja rabbet-alemin.

Amin!

Gëzuar dhe me mirësi e begati, këtë ditë të bekuar, të Kurban Bajramit!

Hytbeja e mbajtur me rastin e Kurban Bajramit, në sheshin bri xhamisë "Ebu Bekër", më 1 shtator 2017

Ditën e shtunë, më 26 gusht 2017, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi një aktivitet veror në kompleksin sportiv “Zmijani”, ku mbledhi nxënës të disa mejtepe fetare që zhvillohen pranë xhamive të Shkodrës.

Në këtë aktivitet argëtues morën pjesë 350 nxënës, si dhe mësuesit e tyre, përfaqësues nga Myftinia, etj.

Drejtori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në fjalën hapëse dhe përshëndetëse i uroj mirëseardhjen të gjithë nxënësve, duke u përcjellë mesazhe për brumosjen e vazhdueshme dhe permanente në besimin tek Zoti (xh.sh), respektimin e parimeve të tij, pajisjen me moral të shëndoshtë dhe përhapjen e modelit të mirë të dashurisë dhe harmonisë.

Ndër të tjera, ai theksoi se Islami është gjithëpërfshirës, preket në çdo aspekt, siç është edhe rasti i sotëm i argëtimit, zbavitjes dhe shijimit të jetës në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të lejueshme.

Në vazhdim të programit, nën drejtimin e mësuesve të edukimit fizik, nxënësit zhvilluan lojëra të ndryshme sportive dhe argëtuese si: futboll, voleyboll, basketboll, tenis, lojëra të ndryshme zbavitëse, si dhe nuk munguan bashkëbisedime në mes nxënësve të ndarë në grupe të ndryshme.

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë imamët dhe mësuesit e këtyre kurseve fetare pranë xhamive të qytetit dhe të fshatit për përkushtimin e tyre maksimal

AKTIVITET VEROR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE



në edukimin e brezit të ri me edukatën dhe moralin e bukur të Islamit, për të

qenë njerëz të dobishëm për vendin dhe shoqërinë.

NISËM VULLNETARE NGA INSTITUCIONET VENDORE PËR PASTRIMIN E VARREZAVE MYSLIMANE “KOMANE”

Nën kujdesin e Myftinisë Shkodër, ndërmarrja e Ujësjellësit Shkodër, me mbështetjen e Bashkisë kanë ndërmarrë të enjten, më 30 gusht 2017 një nisëm vullnetarë për pastrimin e varrezave myslimane “Komane”.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në një prononcim mediatik, pasi falënderoi institucionet për këtë sensibilizim tha se, edhe më herët Myftinia Shkodër ka realizuar projekte për pastrimin e këtyre varrezave, duke u bërë thirrje familjarëve që kujdesen edhe ata për mirëmbajtjen e këtyre varrezave, të cilat janë trashëgimi i vyer e kulturës së qytetit tonë.

Ndër të tjera, ai tha se ky sensibilizim nëpërmjet Myftinisë Shkodër, Bashkisë dhe ndërmarrjes së Ujësjellësit do të



vazhdojë edhe në të ardhmen me hapa të tjera, të cilat kanë të bëjnë jo vetëm për pastrimin e këtyre varreve të vjetra mbi 300 vjeçare, por edhe për sistemin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Myftinia Shkodër falënderon ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkinë e Shkodrës për këtë iniciativë të bukur në sistemin dhe pastrimin e varrezave “Komane”.

KURBAN BAJRAM - DITË NDËRGJEGJËSIMI..!

Që në orët e para të ditës së xhuma, më 1 shtator 2017, besimtarë të shumtë myslimanë, kanë mbushur sheshin pranë xhamisë “Ebu Bekër” për faljen e namazit të sabahut dhe pjesëmarrjen në ceremoninë e Kurban Bajramit të këtij vit.

Siç është bërë traditë, në varësi të kushteve të motit, ceremonia e faljes së Bajrameve zhvillohet jashtë xhamive dhe përkatësisht në Fushë Çelë, pranë xhamisë së madhe, “Ebu Bekër”.

Pas faljes së namazit të sabahut nën drejtimin e teologut Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër” ka filluar edhe programi i ceremonisë së kësaj dite feste.

Fillimisht teologu Arben Halluni bëri hapjen e ceremonisë, duke i uruar këtë festë të madhe të gjithë myslimanëve kudo që ndodhën dhe pastaj bëri edhe prezantimin e programit me rastin e festës së Kurban Bajramit.

Në këtë program mbajtën ligjërata të dobishme dhe me rëndësi teologët dhe imamët e nderuar të Shkodrës, Adem Pizga, Idmir Plaku, Gilman Kazazi dhe Arben Halluni. Përmes argumenteve dhe



shembujve konkretë, imamët e nderuar hodhën dritë mbi mesazhet dhe mësimet universale të fesë islame dhe parimeve të saj.

Faljen e namazit të Kurban Bajramit e drejtoi Lavdrim Hamja, sikurse mbajti edhe hytben e rastit.

Në hytben e Kurban Bajramit, imami i xhamisë së “Dy Vajzave, teologu Lavdrim Hamja, vuri theksin te rëndësia që ka Njësimi i Allahut dhe mbajtja e besimit,

duke u përqendruar se mbikëqyrja e Zotit të Madhëruar është përherë prezent dhe e vazhdueshme, ndaj çdolloj padrejtësie dhe zullumi që ndodh në botë.

Dita e Kurban Bajramit, është festa që lidhet me kryerjen e ritualeve të haxhit në Mekë nga miliona besimtarë myslimanë të ardhur prej të katër anëve globit, duke dëshmuar harmoninë, barazinë, solidaritetin dhe vlerat e besimit.

MIQ DHE VIZITORË TË SHUMTË UROJNË FESTËN E KURBAN BAJRAMIT

Ditën e parë të Kurban Bajramit, më 1 shtator 2017, pas kryerjes së ceremonisë dhe faljes së Kurban Bajramit, Myftinia Shkodër ka organizuar pritjen tradicionale të miqve dhe vizitorëve, me rastin e kësaj dite të madhe për mbarë ymetin islam.

Imamët dhe këshilltarët e pranishëm të Myftinisë Shkodër, në mungesë të Myftiut, Imam Muhamed Sytari, i cili këtë ndodhet në Haxh, kanë pritur me këtë rast në ambientet e xhamisë së Parrucës miqtë dhe vizitorët e ndryshëm, duke nisur nga drejtuesit më të lartë të institucioneve fetare të Shkodrës, drejtuesit e institucioneve vendore e lokale, deputetët, intelektualët dhe besimtarët e shumtë.

Pritja tradicionale me rastin e festave fetare dhe respektimi i tyre në Shkodër, nxjerr në pah harmoninë dhe bashkëjetesën fetare, si një gjurmë e traditës së respektimit të fesë së tjetrit,



sidomos në këto ditë, kur mbarë bota islame gëzon dhe feston mirësitë e Kurban Bajramit.

Myftinia Shkodër lutet që paqja,

harmonia, toleranca dhe mëshira e Zotit të mbizotërojnë gjithë botën, veçanërisht në Siri dhe Burma, ku myslimanët po vriten dhe persekutohen si asnjëherë tjetër në historinë e njerëzimit!

OKB: 146 MIJË MYSLIMANË ROHINGIANË KANË IKUR NË BANGLADESH



Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR) njoftoi se numri i myslimanëve të Arakanit që kanë arritur në Bangladesh duke ikur nga sulmet e ushtrisë së Mianmarit dhe budistëve radikalë ka arritur në 146 mijë.

Robert Watkins, koordinatori i Përhershëm i Organizatës së Kombeve

të Bashkuara (OKB) në Bangladesh, në një deklaratë për agjencinë e lajmeve EFE, tha se në 24 orë të fundit edhe 23 mijë myslimanë të Arakanit kanë kaluar në Bangladesh.

Watkins thekoi se, me këtë shpërngulje të fundit numri i myslimanëve të Arakanit që kanë ikur në Bangladesh që nga 25

gushti, kur edhe filluan sulmet e ushtrisë së Mianmarit dhe budistëve radikalë, është 146 mijë.

Ndërkaq si pasojë e sulmeve të ushtrisë së Mianmarit, e cila pretendon se është duke luftuar militantët e armatosur, që nga 25 gushti e këtij kanë humbur jetën një numër i madh myslimanë rohingianë.

Gjatë sulmeve të ushtrisë janë marrë në shënjestër mbi 60 fshatra, ndërsa dhjetëra prej tyre janë djegur. Dhjetëra-mijëra myslimanë të Arakanit përpiqen të ikin nga rajoni për shkak të sigurisë, duke shkuar në zona relativisht më të sigurta ose duke u përpjekur të kalojnë në Bangladesh nëpërmjet rrugëve ilegale.

Numri i saktë i viktimave ende nuk mund të verifikohet, për arsye se qeveria e Mianmarit nuk lejon hyrjen e organizatave ndërkombëtare. Organizatat e shoqërisë civile në Arakan bëjnë të ditur se numri i civilëve që kanë humbur jetën ka kaluar mbi një mijë, ndërsa disa të tjera pohojnë se bilanci është disa mijëra.

Po ashtu, qeveria e Mianmarit nuk po lejon shpërndarjen e ndihmave humanitare për myslimanët e Arakanit që kanë marrë rrugën e migrimit ose kanë mbetur pa shtëpi. - (www.aa.com.tr/sq)

“SAVE THE CHILDREN”: RRIPI I GAZËS I PAJETUESHËM PËR 1 MILIONË FËMIJË



Sipas një raporti të publikuar nga fondacioni ndërkombëtar me seli në Londër, “Save the Children”, më shumë se 740 shkolla në Rripin e Gazit, ku ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike në ditë mesatarisht në ditë shkojnë nga 2 deri në 4 orë, luftojnë për të mbijetuar.

Po ashtu edhe institucionet shëndetësore dhe të urgjencës janë në një gjendje të keqe dhe kjo vë në

rrezik jetën e fëmijëve, vijon raporti i organizatës, e cila paralajmëron edhe për një fatkeqësi mjedisore të mundshme për shkak të mostrajtimit të ujërave të zeza.

Raporti vë në dukje se për shkak të kushteve të këqija shumë fëmijë e kanë të vështirë të flenë, të mësojnë dhe luajnë.

“Një milion fëmijë në Gaza sot

jetojnë në kushte të tmerrshme”, thekson raporti.

Shumë banorë të Gazës kaluan në errësi këtë vit edhe Festën e Kurban Bajramit.

“Save the Children” përmes raportit të saj i bën thirrje Izraelit të heqë embargon që zbaton ndaj Rripit të Gazës dhe akuzon komunitetin ndërkombëtar për mos-reagim ndaj dhimbjeve e vuajtjeve të fëmijëve palestinezë.

Ndërkaq edhe Kombet e Bashkuara (OKB) raportuan muajin e kaluar se kushtet e jetesës në Rripin e Gazës, po përkeqësoheshin më shpejt sesa parashikimet.

Raporti i OKB-së paralajmëron se burimi i vetëm i ujit në Rripin e Gazës do të jetë plotësisht i shteruar deri në vitin 2020 nëse nuk veprohet urgjentisht

Në Rripin e Gazës jetojnë dy milionë palestinezë dhe që nga viti 2006 e këtij zona ndodhet nën bllokadën izraelite nga toka, ajri dhe deti.

(www.radiojehona.al)

TURQIA ME LIGJ TË RI PËR MARTESËN, THYHET PARIMI I SEKULARIZMIT



Qeveria turke ka paraparë një ligj të ri, i cili i lejon imamët të kurorëzojnë çiftet e reja, duke shënuar kështu një tjetër risi që e anashkalon sekularizmin e shtetit Euro-Aziatik.

Sipas ligjit të ri, imamët do të kenë autoritet të kurorëzojnë çiftet e reja, dhe validiteti i martesës do të jetë i njëjtë me atë që bëhet në gjendjen civile.

Sado që janë shprehur kundërshtime lidhur me ligjin e ri, pasi “u frikësohen” martesës nën moshën 18 vjeçare, apo martesës me më shumë se një grua,

ligji parasheh që myftinjët duhet të respektojnë po të njëjtat dispozita me ato të zyrtarëve të gjendjes civile që vendosin në letër martesën e cifteve të reja. Pra, rregulloret mbesin njëjtë: Martesa mund të realizohet me vetëm një grua, dhe nga mosha 18 vjeç e sipër.

Një tjetër statistikë nga “arena e martesave” në Turqi, e që poashtu është risi, vjen nga numri në rënie i divorceve në krahasim me vitet e kaluara. Po poashtu është shënuar edhe rënie në numrin e kurorëzimeve.

(www.mesazhi.com)

NË VEND TË BIZHUTERIVE, NUSJA I KËRKON DHËNDRIT NJË LISTË ME LIBRA



Sahla Nechiyil, një vajzë muslimane nga Kerla, Indi, vendosi të mos kërkonte flori ose bizhuteri të shtrenjta për ‘Mehër’, një shumë e detyruar që dhëndri duhet t’i japë nuses së tij të ardhshme si dhuratë martesë. Në vend të kësaj, ajo kërkoj një listë me 50 libra, duke dalë kështu kundër traditës së vendit të saj.

Kërkesa e vajzës së diplomuar në shkencat politike është një mesazh për komunitetin e saj të fiksuar pas ‘floririt’. “Unë doja t’u tregoja njerëzve të mi se një dasmë mund të bëhet edhe pa u futur në telashet e përcaktimit të sasisë së floririt mes palëve.”

Enes Nadodi, dhëndri, e mbështet vendimin e saj. Sipas tij mehri është e drejta e gruas, jo bujaria e burrit. Ajo i ka dhënë atij një listë me librat që donte të kishte për “mehër” dhe ai është nisur në kërkim të tyre duke udhëtuar nga Kerala në Bangleore, ndonëse përkundër dëshirës së të dyja familjeve. Lista e librave të kërkuar prej Sahlës përfshin literaturë islame, libra artistikë dhe libra nga fusha e politikës.

Po ju vajza, çfarë keni kërkuar për mehër?

(www.facebook.com/HijabIsMyPrideAlbania)



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

“Më i miri prej jush

është ai, që është

më i mirë për familjen

(bashkëshorten) e tij

dhe unë jam më i miri

prej jush për familjen

(bashkëshorten) time”.

(transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh)

"Kush shkel në një rrugë
për të kërkuar dituri,
Allahu ia lehtëson atij rrugën
për në xhennet.
Melekët shtrijnë krahët e tyre
për kërkuar dituri,
në shenjë kënaqësie
për veprimin që po bën".

*(Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh,
Ibn Hibbani në "Sahihun" e tij dhe Bejhakiu, nga Ebu Derda)*



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org